



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arhivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	3021
Nr. i fq./Br. Sb./No. pg.	5+5+5
Data/Datum/Date	13.08.2024
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.23/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
(MBPZHR) - NR.02/2004 PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE PËR
LICENCIMIN E IMPORTUESVE, PËR TREGTIMIN DHE DEPONIMIN E
PLEHRAVE ARTIFICIALE

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.23/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 02/2004 për caktimin e kushteve për licencimin e importuesve, për tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 4, nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr.2003/10 për Plehrat Artificiale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16/01.09.2007), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.23/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR)
- NR.02/2004 PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE PËR LICENCIMIN E IMPORTUESVE,
PËR TREGTIMIN DHE DEPONIMIN E PLEHRAVE ARTIFICIALE**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR.02/2004 për caktimin e kushteve për licencimin e importuesve, për tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që e përcakton licencimin e importuesve, për tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale.

Neni 2

Neni 2 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 2

1. Personat të cilët merren me importimin dhe tregtimin e plehrave artificiale duhet të regjistrohen pranë Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari

2. Personi për t'u regjistruar si importues, tregtues dhe deponues i plehrave artificiale duhet të plotësoj këto kushte dhe krietere:

2.1. për personat juridik, informatën se janë të regjistruar si biznes në regjistrin përkatës të bizneseve;

2.2. të ketë përgatitje të mesme profesionale nga lëmia e bujqësisë ose të ketë të punësuar personin me përgatitje shkollore të mesme në lëmin e bujqësisë. Për këtë kriter duhet të ofrohet dëshmia e shkollimit dhe kopja e kontratës që dëshmon punësimin.

2.3. të dëshmojë se posedon me objekte përkatëse për deponimin, ruajtjen dhe shitjen e plehrave artificiale të cilat përveç kushteve teknike të ndërtimit i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

2.3.1. të jenë të mbuluara;

2.3.2. të mos kenë lagështi dhe të mos i nënshtrohen kushteve atmosferike - të mos iu ekspozohen diellit, shiut dhe të reshurave të tjera dhe si të tilla nuk lejohen të shiten;

2.3.3. të jenë të ndara fizikisht, nga produktet ushqimore dhe

2.3.4. paketimet të mos jenë të dëmtuara.

3. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni për t'u regjistruar për import të plehrave artificiale, duhet të plotësohet edhe këto kushte dhe kritere:

3.1. Autorizimin nga Kompania prodhuese për llojet e importimit të plehrave artificiale që i tregton;

3.2. Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos.

4. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni për t'u regjistruar për tregtim të plehrave artificiale, duhet të plotësohet edhe këto kushte dhe kritere:

4.1. Diploma e Fakultetit të Bujqësisë;

4.2. Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos.

Neni 3

Neni 3 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet në tërësi së në vijim:

Neni 3

1. Për t'u regjistruar si importues, tregtues dhe deponues i plehrave artificiale, personi duhet të aplikoj në sitemin elektronik i cili administrohet nga AUV. Aplikimi kryhet përmes kërkesës e cila parashtrahet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative. Kërkesa përmban:

1.1. emrin dhe adresën e të regjistruarit;

1.2. emrin dhe adresën e çdo pike qarkulluese të të regjistruarit në Kosovë.

2. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kritereve nga neni 3 i këtij udhëzimi administrativ organi kompetent kryen regjistrimin brenda një afati prej 30 ditëve të punës nga paraqitja e kërkesës.
3. Gjatë zhvillimit të procedurës së regjistrimit zbatohen rregullat e LPPA.

Neni 4

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 4

1. Për regjistrimin e personave si importues, tregtues dhe deponues i plehrave artificiale nga organi kompetent lëshohet certifikatë e cila përmban:

- 1.1. emrin dhe logon e organit kompetent;
- 1.2. numrin identifikues të certifikatës dhe datën e lëshimit;
- 1.3. të dhënat e personit të regjistruar;
- 1.4. llojin e plehrave artificiale për të cilin bëhet regjistrimi;
- 1.5. lloji i veprimtarisë me të cilën ka të bëjë regjistrimi;
- 1.6. vendi i veprimtarisë, nëse ka;
- 1.7. nënshkrimi i personit të autorizuar për të nënshkruar në emër të organit kompetent. Nënshkrimi bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

2. Në sistemin elektronik krijohet certifikata elektronike e cila përmban të gjitha elementet sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes sistemit elektronik.

Neni 5

Pas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ bazik shtohen dy nene 7A dhe 7B si në vijim:

Neni 7A

Vlefshmëria e certifikatës së regjistrimit

1. Secila certifikatë e dhënë e regjistrimit, përveç nëse është pezulluar ose anuluar, do të jetë e vlefshme për një periudhë maksimale tri (3) vjeçare, llogaritur prej datës së regjistrimit dhe do të përtërihet me pagesën e taksës së kërkuar për regjistrim.

2. Personat paraqesin kërkesë për vazhdimin e regjistrimit për import dhe tregtim të plehrave artificiale së paku në afatin kohor 30 ditësh para skadimit të afatit të certifikatës së regjistrimit.

3. Për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së regjistrimit duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 2 nën paragrafin 2.3, paragrafi 3 dhe nën paragrafi 4.2 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 7B Taksat

1. Shuma e taksës për regjistrim të subjekteve të cilët importojnë plehra artificiale është 50€ ndërsa për vazhdim të regjistrimit 45€.

2. Shuma e taksës për regjistrim të subjekteve të cilët tregtojnë plehra artificiale është 40€ ndërsa për vazhdim të regjistrimit 30€.

Neni 6

Në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “MBPZHR” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 7

Në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “MBPZHR” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 8

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.04/2009 Për caktimin e taksës për licencimin e subjekteve që merren me import dhe tregtim të plehrave artificiale.

Neni 9 Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Faton PEÇI
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

